

Komunikatë për media

Shoqata Sindikale e “ Feronikeli ”-t nga Drenasi, e udhëhequr nga Kryetari Fehmi Nika, me dt 28.01.2011 mbajti i Kuvendin e saj, në përbërje të plotë.

Meqë pikat e rendit të ditës kishin të bëjnë lidhur me marrjen e disa vendimeve të rëndësishme për këtë subjekt sindikal, Kuvendi i saj u monitorua nga ana e Kryetarit të BSPK-së Z. Haxhi Arifi.

Pas shpjegimit të normave statusore nga ana e përfaqësuesve të Kryesisë së këtij subjekti sindikal, lidhur me formimin e degës konform Statutit të BSPK-së dhe elaborimit të rrjedhave sindikale në vend nga ana e Kryetarit të BSPK-së Z. Haxhi Arifi , si dhe debatit të pastajmë nga delegatet e pranishëm, me këtë rast ky Kuvend mori këto:

VENDIME

- Shoqata Sindikale e “ Feronikeli ”-t nga Drenasi, tash e tutje do të veproj në cilësi të Degës Sindikale nën emërtimin: **Sindikata e Pavarur e Metalurgjisë dhe Industrisë Kimike të Kosovës.**
- Këtij subjekti sindikal mund t’i bashkëngjiten edhe shoqatat e tjera sindikale të subjekteve ekonomike të Kosovës, që kanë ngjashmëri me veprimtarinë punuese profesionale me këtë subjekt ekonomik, të cilën e përfaqëson kjo sindikatë.
- Kjo Degë sindikale shprehë vullnetin e punëtorëve që i përfaqëson për t’iu bashkëngjitur BSPK-së sipas kushteve që i parasheh Statuti i këtij subjekti sindikal.
- Të gjitha procedurat administrative për regjistrimin e kësaj Dege në Ministrin përkatëse, duhen të kryhen nga ana e Kryesisë së saj, në harmonizim me aktet normative të BSPK-së.